**VENDIM**
**Nr. 24, datë 29.5.2013**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Bashkim Dedja | kryetar i Gjykatës Kushtetuese | | |
| Sokol Berberi | anëtar i | “ | “ |
| Vitore Tusha | anëtare e | “ | “ |
| Altina Xhoxhaj | anëtare e | “ | “ |
| Fatmir Hoxha | anëtar i | “ | “ |
| Gani Dizdari | anëtar i | “ | “ |
| Besnik Imeraj | anëtar i | “ | “ |
| Fatos Lulo | anëtar i | “ | “ |
| Vladimir Kristo | anëtar i | “ | “ |

me sekretare Blerina Basha, në datën 28.5.2013, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 17 Akti, që i përket:

KËRKUES: Feta Bundo

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Zyra Përmbarimore Tiranë

OBJEKTI: Ndreqje gabimi në shkrim, në vendimin nr. 12, datë 16.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 80, pika 2 e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, shqyrtoi kërkesën e paraqitur dhe diskutoi çështjen në tërësi:

VËREN:

I

1. Kërkuesi Feta Bundo i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, me objekt: “Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm”.

2. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 12, datë 16.4.2013, ka vendosur:

*“Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 17, datë 15.3.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë brenda një afati të arsyeshëm”.*

3. Pas zbardhjes së vendimit, kërkuesi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, me objekt: “*Ndreqje gabimi në vendimin nr. 12, datë 16.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese”*.

II

4. Gjykata Kushtetuese, pasi administroi vendimin nr 12. datë 16.04.2013, konstaton se janë bërë gabime materiale dhe konkretisht:

- në faqen 3, pika 4, në vend të **“vendim nr. 17, datë 15.3.2005”** duhet të ishte shkruar **“vendim nr. 17, datë 15.3.2006”**;

- në faqen 11 të vendimit, në dispozitiv është shkruar **“vendimit nr. 4894, datë 14.6.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”**, duhet të ishte **“vendimit nr. 17, datë 15.3.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë”.**

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Ndreqjen e vendimit nr. 12, datë 16.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese, si vijon:
- në vend të **"vendim nr. 17, datë 15.3.2005"** do të jetë **"vendim nr. 17, datë 15.3.2006"**;
- në dispozitiv, në vend të **"vendimit nr. 4894, datë 14.06.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë"**, do të jetë **"vendimit nr. 17, datë 15.3.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë".**
- Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit nr. 12, datë 16.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vladimir Kristo, Fatos Lulo, Besnik Imeraj.